



RREGULLAT ZYRTARE TË VOLEJBOLLIT NË RËRË 2021-2024

Aprovuar nga Kongresi i 37të i FIVB 2021

Rregullat Zyrtare të Volejbollit në Rëre 2021-2024

Publikuar nga FIVB në 2021 - www.fivb.com

Dizajni, koperina dhe ilustrimet: © FIVB 2021



RREGULLAT ZYRTARE TË VOLEJBOLLIT NË RËRË 2021-2024

Aprovuar nga Kongresi i 37^{të} i FIVB 2021

Të implementohen në të gjitha garat nga 1 Janari 2022

PËRMBAJTJA

KARAKTERISTIKAT E LOJËS	7
PJESA 1: FILOZOPIA DHE RREGULLAT E REFERIMIT	8
PJESA 2 - SEKSIONI 1: LOJA	11
KAPITULLI 1: OBJEKTET DHE PAISJET	12
1 ZONA E LOJËS.	12
1.1 DIMENSIONET	12
1.2 SIPËRFAQJA E LOJËS	12
1.3 VIJAT NË FUSHË.....	13
1.4 ZONAT DHE HAPËSIRAT	13
1.5 KUSHTET ATMOSFERIKE	13
1.6 NDRIÇIMI	13
2 RRJETA DHE SHTYLLAT	13
2.1 LARTËSIA E RRJETËS	13
2.2 STRUKTURA.....	14
2.3 BANDAT ANËSORE	14
2.4 ANTENAT	14
2.5 SHTYLLAT	15
2.6 PAISJET SHITESË.....	15
3 TOPAT.....	15
3.1 STANDARDET.....	15
3.2 UNIFORMITETI I TOPAVE.....	15
3.3 SISTEMI I KATËR TOPAVE.....	15
KAPITULLI 2: PJESËMARRËSIT	16
4 EKIPET	16
4.1 PËRMBËRJA E EKIPIT	16
4.2 LOKACIONI I EKIPIT	16
4.3 PAISJET	16
4.4 NDËRRIMI I PAISJEVE	17
4.5 OBJEKTET E NDALUARA.....	17
5 LIDERËT E EKIPAVE	17
5.1 KAPITENI.....	17

6	SHËNIMI I PIKËS, FITIMI I SETIT DHE LOJËS.....	19
6.1	FITIMI I PIKËS	19
6.2	FITIMI I SETIT	20
6.3	FITIMI I NDESHJES	20
6.4	EKIPI I PA KOMPLETUAR	20
7	STRUKTURA E LOJËS.....	20
7.1	SHORTI	20
7.2	NXEMJA ZYRTARE	21
7.3	FORMACIONI I EKIPIT	21
7.4	POZITAT	21
7.5	POZICIONIMI GABIM	21
7.6	RADHA E SHËRBIMIT	21
7.7	GABIMI NË RADHË TË SHËRBIMIT	21

8	STATES OF PLAY	22
8.1	TOPI NË LOJË.....	22
8.2	TOPI JASHTË LOJE.....	22
8.3	TOPI “BRENDA”	22
8.4	TOPI “JASHTË”	22
9	LOJA ME TOP	23
9.1	KONTAKTI ME TOP.....	23
9.2	KARAKTERISTIKAT E KONTAKTIT ME TOP	24
9.3	GABIMET GJATË LOJËS ME TOP	24
10	TOPI NË RRJETË	24
10.1	KALIMI I TOPIT MBI RRJETË	24
10.2	KONTAKTI I TOPIT ME RRJETË	25
10.3	TOPI NË RRJETË.....	25
11	LOJTARI NË RRJETË.....	25
11.1	KONTAKTI MBI RRJETË	25
11.2	KALIMI NË HAPËSIRËN E KUNDËRSHTARIT OSE ZONËN E LIRË	25
11.3	KONTAKTI ME RRJETË	25
11.4	GABIMET E LOJTARIT NË RRJETË	26
12	SHERBIMI.....	26
12.1	SHËRBIMI I PARË NË SET	26
12.2	RADHA E SHËRBIMIT	26
12.3	AUTORIZIMI I SHËRBIMIT	27
12.4	EKZEKUTIMI I SHËRBIMIT.....	27

12.5	EKRANI	27
12.6	GABIMET NË SHËRBIM	27
13	GJUAJTJA-GODITJA	28
13.1	KARAKTERISTIKAT E GJUAJTJES-GODITJES	28
13.2	GABIMET GJATË GJUAJTJES-GODITJES	28
14	BLLOKU	28
14.1	BLLOKIMI	28
14.2	KONTAKTI NË BLLOK	29
14.3	BLLOKU NË HAPËSIRËN E KUNDËRSHTARIT	29
14.4	BLLOKU DHE KONTAKTET E EKIPIT ME TOPIN	29
14.5	BLLOKU I SHËRBIMIT	29
14.6	GABIMET NË BLLOK	29

KAPITULLI 5: NDËRPRERJET, VONESAT DHE INTERVALET		30
---	--	-----------

15	NDËRPRERJET	30
15.1	NUMRI I NDËRPRERJEVE TË RREGULLTA TË LOJËS	30
15.2	SEKUENCA E NDËRPRERJEVE TË RREGULLTA TË LOJËS	30
15.3	KËRKESAT PËR NDËRPRERJE TË RREGULLTA TË LOJËS	30
15.4	PUSHIMET DHE PUSHIMET TEKNIKE	30
15.5	KËRKESAT E PARREGULLTA	31
16	VONESAT E LOJËS	31
16.1	LLOJET E VONESAVE	31
16.2	DENIMET E VONESAVE	31
17	NDËRPRERJET E JASHTËZAKONSHME TË LOJËS	32
17.1	LENDIMET/ SËMUNDJET	32
17.2	PENGESAT E JASHTME	32
17.3	NDËRPRERJET E GJATA	32
18	INTERVALET DHE NDËRRIMI I FUSHAVE	33
18.1	INTERVALET	33
18.2	NDËRRIMI I FUSHAVE	33

KAPITULLI 6: SJELLJET E PJESËMARRËSVE 34

19 KËRKESAT E SJELLJEVE	34
19.1 SJELLJET SPORTIVE	34
19.2 FAIR PLAY	34
20 SJELLJET JO SPORTIVE DHE DËNIMET	34
20.1 SJELLJET JO SPORTIVE MINORE	34
20.2 SJELLJET JO SPORTIVE TË SANKSIONUESHME	35
20.3 SHKALLA E SANKSIONEVE	35
20.4 SJELLJET JO SPORTIVE NË FILLIM DHE GJATË SETAVE	35
20.5 PËRMBLEDHJE E SJELLJEVE JO SPORTIVE DHE KARTONAT QË IPEN	36

PJESA 3 - SEKSIONI 2: GJYQTARËT, PËRGJEGJËSITË DHE SHENJAT E DUARVE 37

KAPITULLI 7: GJYQTARËT 38

21 EKIPI I GJYQTARËVE DHE PROCEDURAT	38
21.1 PËRBËRJA	38
21.2 PROCEDURAT	38
22 GJYQTARI I PARË	39
22.1 VENDI	39
22.2 AUTORITETI	39
22.3 PËRGJEGJËSITË	40
23 GJYQTARI I DYTË	40
23.1 VENDI	40
23.2 AUTORITETI	40
23.3 PËRGJEGJËSITË	41
24 GJYQTARI SFIDUES	42
24.1 VENDI	42
24.2 PËRGJEGJËSITË	42
25 GJYQTARI REZERVË	42
25.1 VENDI	42
25.2 PËRGJEGJËSITË	42
26 PIKËSHENUESI	43
26.1 VENDI	43
26.2 PËRGJEGJËSITË	43
27 NDIHMËSI I PIKËSHENUESIT	44
27.1 VENDI	44
27.2 PËRGJEGJËSITË	44

28	GJYQTARËT E VIJAVE.....	44
28.1	VENDI.....	44
28.2	PËRGJEGJËSIT.....	45
29	SHENJAT/SINJALET ZYRTARE.....	45
29.1	SHENJAT/SINJALET E DUARVE.....	45
29.2	SINJALET ME FLAMUR TË GJYQTARËVE TË VIJAVE.....	45

PJESA 2 - SEKSIONI 3: DIAGRAMET 47

D1	HAPËSIRA E LOJËS.....	48
D2	FUSHA E LOJËS.....	49
D3	PËRBËRJA E RRJETES.....	50
D4a	TOPI KALON PLANIN VERTIKAL TË RRJETES NË FUSHËN E KUNDËRSHTARIT.....	51
D4b	TOPIT KALON PLANIN VERTIKAL TË RRJETES NË HAPËSIREN E LIRË TË KUNDËRSHTARIT.....	52
D5	EKRANI.....	53
D6	BLLOKU AKTIV.....	53
D7	PARANDALIMET DHE SANKSIONET.....	54
D7a	VËREJTJA PËR SJELLJET JO SPORTIVE, SANSKSIONET DHE PASOJAT.....	54
D7b	SANKSIONET E VONESAVE, SHKALLA DHE PASOJAT.....	54
D8	VENDQENDRIMI I EKIPIT TË GJYQTARËVE DHE NDIHMËSVE.....	55
D9	SHENJAT/SINJALET ZYRTARE TË DUARVE.....	56-62
D10	SHENJAT/SINJALET ZYRTARE ME FLAMUR TË GJYQTARËVE TË VIJAVE.....	63-64

PJESA 3: DEFINICIONET 65

INDEKSI 68





KARAKTERISTIKAT E LOJËS

Volejboli në rërë është sport që luhet nga dy ekiye në fushë me rërë të ndarë me rrjetë në mes.

Ekipi ka në dispozicion tri takime për të kthyer topin (përfshirë bllokun si takim).

Në volejbollin në rërë, ekipi që fiton aksionin shënon pikë. Kur ekipi që është në pranim fiton aksionin, ai gjithashtu fiton të drejten e shërbimit. Sa here që ndodhë një veprim i till, lojatri që shërben ndërrohet.




PJESA 1
FILOZOFIA E
RREGULLAVE DHE
REFERIMIT

INTRODUCTION

By every measure, Beach Volleyball is one of the world's most successful and popular sports - it has larger TV viewing figures, larger followers on social media, greater (and growing) numbers of registered and recreational players, than almost any other sport, and an image which is dynamic, clean and colorful, combining, especially at the competitive levels, a visual and audible feast to satisfy every palate.

Put simply, it is **fast**, it is **exciting** and the action is **explosive**. Yet the Beach form of Volleyball comprises several crucial overlapping elements whose complimentary **interactions** render it unique amongst rally games, and create a special charm to differentiate it from other forms of the sport.



FIVB VOLEJBOLLI NË RËRË ËSHTË SPORT GARUES

Gara prek pikat e forta latente. Shfaq më të mirën e aftësive, shpirtin, kreativitetin dhe estetikën. Rregullat janë të strukturuar për të lejuar të gjitha këto cilësi. Eksponentët e hershëm të lojës në plazhet e Kalifornisë do ta njohin akoma atë. Megjithatë, vitet e fundit FIVB ka bërë ndryshime të mëdha në përshtatjen e lojës me një audiencë moderne.

Në këtë drejtim, volejboli në rërë ka ruajtur disa elemente dalluese dhe thelbësore ndër vite. Disa prej tyre i ndan me lojërë të tjera rrjetë/top/raketë: - Shërbimi - Rrotullimi (duke marrë radhën e shërbimit) - Sulmi - Mbrojtja - lojtarë të aftë për të luajtur kudo në fushë.

Por sporti ka ecur para. Sot ai është shumë më eksploziv dhe me spektakular. Është i shpejt dhe dhe vazhdimisht në ngritje; me lojtarë që bëjnë gjëra senzacionale në fushë të mbushur me spektator. Për më tepër, volejboli në rërë është unik në mesin e lojërave të rrjetës duke këmbëngulur që topi të jetë në fluturim të vazhdueshëm - një top fluturues - dhe duke i lejuar çdo skuadër një shkallë pasimi të brendshëm përpara se topi duhet t'u kthehet kundërshtarëve. duke krijuar një ndarje të mirë të topit për të ofruar ar mundësi të barabarta për të shënuar pikë. Vitet e fundit FIVB ka bërë një investim të madh në përdorimin e teknologjisë, me Sistemin e saj të Video Sfidës që ofron drejtësi për përpjekjet e atletëve dhe duke inkurajuar filozofi që promovojnë lojën e rrjedhshme për të argëtuar publikun, si në stadium poashtu edhe në ekran. Garuesit përdorin këtë kornizë për të kontestuar teknikat, taktikat dhe fuqinë. Korniza gjithashtu u lejon lojtarëve lirinë e shprehjes për të entuziazmuar spektatorët dhe shikuesit dhe për të krijuar një spektakël sportiv të pakrahasueshëm.

Si rezultat i kësaj, imazhi i volejbollit në rërë është në rritje e sipër.

RREGULLAT

Ky tekst i drejtohet një audience të gjerë të volejbollit në rërë - lojtarëve, trajnerëve, gjyqtarëve, spektatorëve, komentuesve dhe të tjerëve - sepse të kuptuarit e rregullave lejon lojën më të mirë dhe kënaqësinë personale - trajnerët mund të krijojnë strukturë dhe taktika më të mira të ekipit, duke u dhënë lojtarëve kontroll të plotë për të shfaqur aftësitë e tyre. Për më tepër, një kuptim i marrëdhënies midis rregullave të shkruara dhe veprimeve aktuale në fushë i lejon gjyqtarët të marrin vendime të drejta.

Volejboli në rërë është njëkohësisht rekreativ dhe garues. Sporti rekreativ prek shpirtin njerëzor dhe promovon "argëtimin" dhe jetë të shëndetshme. Gara i lejon njerëzit të shfaqin më të mirën e aftësisë, kreativitetit, lirisë së shprehjes dhe shpirtit luftarak. Rregullat janë krijuar dhe strukturuar për të lejuar që të gjitha këto aspekte të zhvillohen.

Kjo hyrje është fokusuar fillimisht në volejbollin e rërës si një sport garues, përpara se të vendoset për të identifikuar cilësitë kryesore të nevojshme për një gjykim të suksesshëm të ndeshjes.

GJYQTARËT NË KËTË KUADRAT

Thelbi i një gjyqtari të mirë qëndron në konceptin e drejtësisë dhe qëndrueshmërisë:

Të qenit i pozicionuar në mes të të dy fushave të lojës është një simbol i ekuilibrit, duke i inkurajuar lojtarët të besojnë veprimet e gjyqtarit. Megjithatë, gjyqtari duhet të jetë një fasilitator dhe jo një kontrollues, një drejtues orkestre më shumë sesa një diktator, një promovues efikas dhe jo një ndëshkues "efikas".


Duke kuptuar arsyen pse është shkruar një rregull dhe duke qenë i qartë për qëllimet e saj brenda kornizës së "shfaqjes", gjyqtari bëhet një pjesë pozitive e një produkti të suksesshëm, ndërsa mbetet kryesisht në prapavijë dhe ndërhyr vetëm kur është e nevojshme. Mund të themi se një gjyqtarë i mirë do të përdorë rregullat për ta bërë garën një përvojë e cila i përbush të gjithë të interesuarit.

Për ata që kanë lexuar deri më tani, i shihni rregullat si një gjendje aktuale të zhvillimit të një loje të shkëlqyer, por mbani në mend pse këta paragrafë të mëparshëm mund të jenë të një rëndësie të njëjtë për ju në pozicionin tuaj brenda sportit. Kështu që...

**Merrni pjesë !
Mbani topin në fluturim !
Kuptoje lojen !**



PJESA 2
SEKSIONI 1: LOJA



KAPITULLI 1 OBJEKTET DHE PAISJET

See Rules

1 HAPËSIRA E LOJËS

Hapësira e lojës përfshin fushën e lojës dhe zonën e lirë. Ajo duhet të jetë drejtkëndore dhe simetrike.

1.1, D1

1.1 DIMENSIONET

1.1.1 Fusha e lojës është në form drejtkëndëshi me përmasa 16 x 8 m, i rrethuar nga një zonë e lirë, e cila është minimalisht 3 m e gjerë nga të gjitha anët.

Zona e lirë e lojës është hapësira mbi zonën e lojës, e cila është e lirë nga të gjitha pengesat. Hapësira e lirë e lojës duhet të jetë minimalisht 7 m në lartësi nga sipërfaqja e lojës.

D2

1.1.2 Për garat e FIVB, garat botërore dhe ato zyrtare, zona e lire duhet të jetë min. 5 m dhe maks. 6 m nga vijat fundore/vijat anësore. Hapësira e lirë e lojës duhet të jetë min. 12.5 m në lartësi nga sipërfaqja e lojës.

1.2 HAPËSIRA E LOJËS

1.2.1 Sipërfaqja e lojës duhet të jetë e përbërë nga rërë e rrafshuar, sa më e sheshtë dhe uniforme, pa gurë dhe çdo gjë tjetër që mund të paraqesë rrezik për prerje ose lëndime për lojtarët.

1.2.2 Për garat e FIVB, garat botërore dhe zyrtare, rëra duhet të jetë së paku 40 cm e thellë dhe e përbërë nga kokrra të imta të ngjeshura.

1.2.3 Sipërfaqja e lojës nuk duhet të paraqesë ndonjë rrezik lëndimi për lojtarët.

1.2.4 Për garat FIVB, garat botërore dhe zyrtare, rëra duhet gjithashtu të sitet në një madhësi të pranueshme, jo shumë të trashë dhe pa gurë dhe grimca të rrezikshme. Nuk duhet të jetë shumë i imët për të shkaktuar pluhur dhe ngjitje në lëkurë.

1.2.5 Për garat FIVB, garat botërore dhe zyrtare, rekomandohet një mbulesë për të mbuluar fushën qendrore në rast shiu.

1.3 VIJAT NË FUSHË

1.3.1 Të gjitha vijat janë të trasha 5cm. Vijat duhet të kenë ngjyrë të kundërt me rërën.

1.3.2 Vijat kufizuese

Dy vija anësore dhe dy vija fundore shënojnë fushën e lojës. Nuk ka vijë në qender. Të dy vijat, anësore dhe fundore janë të vendosura brenda hapësirës së lojës.

Vijat e fushës duhet të jenë shirita të bërë nga një material rezistent të butë dhe fleksibël.

1.4 ZONAT DHE HAPËSIRAT

Ekziston vetëm fusha e lojës, zona e shërbimit dhe zona e lirë që rrethojnë fushën e lojës.

1.4.1 Zona e shërbimit është një zonë 8 m e gjerë pas vijës fundore, e cila shtrihet deri në skajin e zonës së lire.

1.5 KUSHTET ATMOSFERIKE

Moti nuk guxon të paraqes ndonjë rrezik për lëndim të lojtarëve.

1.6 NDIÇIMI

Për garat e FIVB, garat botërore dhe zyrtare, që luhen gjatë natës, ndiçimi në zonën e lojës duhet të jetë 1000 deri në 1500 luks i matur në 1 m mbi sipërfaqen e zonës së lojës.

2 RRJETA DHE SHTYLLAT**2.1 LARTËSIA E RRJETËS**

2.1.1 Rrjeta është e vendosur vertikalisht në mes të fushës e cila për meshkuj ka lartësinë 2,43 m për meshkuj dhe 2,24 m për femra.

Vërejtje: Lartësia e rrjetës mund të ndryshojë për grupmosha specifike si më poshtë :

Grupmosha	Femrat	Meshkujt
16 vjeçar e më të rinj	2.24 m	2.24 m
14 vjeçar e më të rinj	2.12 m	2.12 m
12 vjeçar e më të rinj	2.00 m	2.00 m

2.1.2 Lartësia matet në qendren e fushës së lojës me një shufër matëse. Lartësia e rrjetës (mbi dy vijat anësore) duhet të jetë saktësisht e njëjtë dhe nuk duhet të kalojë lartësinë zyrtare më shumë se 2 cm.

2.2 PËRBËRJA E RRJETËS

Rrjeta është e gjatë 8,5 m dhe 1 m (+/- 3 cm) e gjerë kur është e tendosur, e vendosur vertikalisht në mes, mbi fushës të lojës.

Është e përbërë nga katrore 10 cm. Në pjesën e sipërme dhe të poshtme të saj ka dy shirita horizontale 7-10 cm të gjera, të bëra nga një shirit i dyfishtë, mundësisht në ngjyrë blu të errët ose të ndezur, të qepura përgjatë gjithë gjatësisë së saj. Çdo skaj i brezit të sipërm ka një vrimë përmes së cilës kalon një kordon që fikson brezin e sipërm në shtyllat për të mbajtur të tendosur rrjetën.

Brenda shiritave ka një kablo fleksibël në pjesën e sipërme dhe një kordon në pjesën e poshtme për të lidhur rrjetën në shtylla dhe për të mbajtur të tendosur pjesën e sipërme dhe të poshtme të saj. Është e lejuar të ketë reklama në shiritat horizontal të rrjetës.

Për garat botërore dhe ato zyrtare të FIVB, mund të përdoret rrjeta 8.0 m me katror dhe marka më të vogla të shfaqura midis skajeve të rrjetës dhe shtyllave, me kusht që të ruhet dukshmëria e atletëve dhe zyrtarëve. Publiciteti mund të shtypet në shiritat e sipërm sipas rregulloreve të FIVB.

2.3 BANDAT ANËSORE

Dy shirita me ngjyra, 5 cm të gjerë (të njëjtën gjerësi si vijat e fushës) dhe 1 m të gjatë, mbërthehen vertikalisht në rrjetë dhe vendosen mbi secilën vijë anësore. Ato konsiderohen si pjesë e rrjetës.

Reklamimi lejohet në shiritat anësore.

2.4 ANTENAT

Antena është një shufër elastike, 1,80 m e gjatë dhe 10 mm në diametër, e përbërë nga material sintetik dhe i fortë.

Antenat janë të fiksuara në skajin e jashtëm të çdo bande anësore. Antenat vendosen në anët e kundërta të rrjetës.

Pjesa e sipërme 80 cm e secilës antenë shtrihet mbi rrjetë dhe shënohet me vija 10 cm me ngjyra të kundërta, mundësisht të kuqe dhe të bardhë.

Antenat konsiderohen si pjesë e rrjetës dhe kufizojnë anash hapësirën e fushës.

D3

14.1.1, D3

2.5 SHTYLLAT

D2, D3

- 2.5.1 Shtyllat që mbajnë rrjeten janë të vendosura në një distance prej 0.70-1.00 jashtë vijave anësore. Ato janë 2.55 m të larta dhe preferohet të jenë të levizëshme.

Për garat botërore dhe ato zyrtare të FIVB, shtyllat që mbajnë rrjetën vendosen në një distancë prej 1 m jashtë vijave anësore.

Shtyllat duhet të jenë të rrumbullakta dhe të lëmuara, të fiksuara në tokë pa tela. Nuk duhet të ketë pajisje të rrezikshme ose që pengojnë. Shtyllat duhet të jenë të mbushura (forta).

2.6 PAISJET SHITESË

Të gjitha pajisjet shtesë përcaktohen nga rregulloret e FIVB.

3 TOPAT

3.2

3.1 STANDARDET

Topi duhet të jetë sferik, i përbërë nga një material fleksibël (lëkurë, lëkurë sintetike ose të ngjashme) që nuk thith lagështi, pra më i përshtatshëm për kushtet e jashtme pasi që ndeshjet mund të luhen kur bie shi. Topi ka një fshikëz brenda prej gome ose një materiali të ngjashëm. Miratimi i materialit prej lëkure sintetike përcaktohet nga rregulloret e FIVB.

Ngjyra: ngjyra uniforme t'lehta ose një kombinim gjyrash

Perimetri: 66-68 cm.

Pesha: 260 to 280 g.

Presioni i brendshëm: 0.175 to 0.225 kg/cm² (171 to 221 mbar or hPa).

3.2 UNIFORMITETI I TOPAVE

Të gjithë topat e përdorur në një ndeshje duhet të kenë të njëjtat standarde në lidhje me perimetrin, peshën, presionin, llojin, ngjyrën, etj.

Për garat botërore dhe ato zyrtare të FIVB, duhet të luhet me topa të miratuar nga FIVB, përveç rasteve kur ka marrëveshje me FIVB.

3.1, 23.2.8

3.3 SISTEMI ME KATËR TOPA

Për garat botërore dhe ato zyrtare të FIVB, duhet të përdoren katër topa. Në këtë rast, gjashtë mbledhës topash vendosen në çdo cep të zonës së lirë dhe një pas çdo gjyqtari.

D8

KAPITULLI 2 PJESËMARRËSIT

See Rules

4 EKIPET

4.1 PËRBËRJA E EKIPIT

- 4.1.1 Një ekip përbëhet nga dy lojtarë.
- 4.1.2 Vetëm lojtarët e regjistruar në protokoll të ndeshjes kanë të drejtë të luajnë në ndeshje.
- 4.1.3 Njëri nga lojtarët është kapiten i ekipit, i cili duhet të evidenohehet në protokoll të ndeshjes. One of the players is the team captain who shall be indicated on the score sheet.
- 4.1.4 **Për garat botërore dhe zyrtare të FIVB, lojtarët nuk lejohen të marrin asistencë ose stërvitje të jashtme gjatë një ndeshjeje (Përfshirjet: shih Rregulloret specifike për Garat e Grupmoshave dhe për Fazat 1 dhe 2 të Kupës Kontinentale).**

4.2 VENDNDODHJA E EKIPIT

Zona e ekipit (duke përfshirë dy karrige) duhet të jenë 5 m nga vija anësore dhe jo më afër se 3 m nga tavolina e shënimit.

4.3 PAISJET

Pajisjet e një lojtari përbëhen nga pantallona të shkurtra. Një fanellë ose "tank-top" është opsionale, përveç kur specifikohet në Rregulloret e Turneut. Lojtarët mund të mbajnë një kapele.

- 4.3.1 **Për garat botërore dhe zyrtare të FIVB, lojtarët e një ekipi të caktuar duhet të veshin uniforma të së njëjtës ngjyre sipas rregulloreve të turneut. Uniformat e lojtarëve duhet të jenë të pastra.**
- 4.3.2 Lojtarët duhet të luajnë këmbëzbathur, përveç rasteve kur autorizohet nga gjyqtari i parë.
- 4.3.3 Fanellat e lojtarëve (ose pantallonat e shkurtra nëse lojtarët lejohen të luajnë pa fanellë) duhet të jenë me numër 1 dhe 2.
 - 4.3.3.1 Numri duhet të vendoset në gjoks (ose në pantollona para).
 - 4.3.3.2 Numri duhet të jetë kontrast nga ngjyra e dresit, min. 10 cm në lartësi dhe së paku 1.5 cm trashësia e numrit.

4.1.1

4.4 NDËRRIMI I PAJISJEVE

Nëse të dyja skuadrat në një ndeshje kanë të veshura fanella të së njëjtës ngjyrë, do të bëhet një hedhje e shortit për të përcaktuar se cila skuadër do të ndryshojë fanellat.

Gjyqtari i parë mund të autorizojë një ose më shumë lojtarë::

- 4.4.1 Të luaj me qorapë apo atlete,
- 4.4.2 për të ndërruar fanellat e lagura ndërmjet seteve me kusht që të rehat të respektojnë gjithashtu rregullat e turneut dhe të FIVB.
- 4.4.3 Nëse kërkohet nga një lojtar, gjyqtari i parë mund ta autorizojë atë të luajë me nënfanella stërvitore.

4.3.3

4.5 OBJEKTE TË NDALUARA

- 4.5.1 Ndalohet veshja e objekteve që mund të shkaktojnë lëndime ose t'i japin një avantazh artificial lojtarit.
- 4.5.2 Lojtarët mund të mbajnë syze ose lente në përgjegjësi të tyre.
- 4.5.3 Mbrojtëset (pajisjet e mbushura për mbrojtjen nga lëndimet) mund të vishen për mbrojtje ose mbështetje.

Për garat botërore dhe zyrtare të FIVB për senior, këto pajisje ose të brendshme të dukshme duhet të jenë të së njëjtës ngjyrë sikurse ngjyra e fanellave.

Mund të përdoren gjithashtu ngjyra të zeza, të bardha ose neutrale me kusht që të gjithë lojtarët që përdorin ta kenë të njëjtën ngjyrë.

5 UDHËHEQËSIT E EKIPI

Kapiteni i ekipit është përgjegjës për disiplinën dhe sjelljet e ekipit.

5.1 KAPITENI

- 5.1.1 PARA FILLIMIT TË NDESHJES, kapiteni i ekipit:
 - a) nënshkruan protokollin e ndeshjes.
 - b) përfaqëson ekipin e tij/saj në short.
- 5.1.2 Gjatë ndeshjes, vetëm kapiteni është i autorizuar të flasë me gjyqtarët kur topi është jashtë lojës në tre rastet e mëposhtme:
 - 5.1.2.1 Për të kërkuar një shpjegim mbi aplikimin ose interpretimin e rregullave; nëse shpjegimi nuk e bind kapitenin, ai duhet të informojë menjëherë gjyqtarin e parë për mundësinë e tij/saj për të protestuar;

8.2

5.1.2.2 të kërkoj autorizim :

- a) Të ndërroj fanellat apo paisjet,
- b) Të verifikoj radhën e lojtarit në shërbim,
- c) Të kontrolloj rrjeten, topat, fushën etj,
- d) Të rregulloj vijat e fushës;

5.1.2.3 Të kërkoj time-out.

Vërejtje: lojtarët duhet të kenë lejen e gjyqtarëve për të dale jashtë hapësirës së lojës.

5.1.3 NË FUND TË NDESHJES:

5.1.3.1 Të dy lojtarët falenderojnë gjyqtarët dhe ekipin kundërshtarë. Kapiteni i ekipit nëshkruan protokollin e ndeshjes për të konfirmuar rezultatin.

5.1.3.2 Nëse kapiteni ka kërkuar më parë një proteste nëpërmjet gjyqtarit të parë dhe kjo nuk është zgjidhur me sukses në momentin e ndodhjes, ai/ajo ka të drejtë ta konfirmojë atë si një protestë zyrtare me shkrim, të regjistruar në protokoll në fund të ndeshjes.

15.2.1, 15.4.1

5.1.2.1



KAPITULLI 3

FORMAT I NDESHJES

See Rules

6 SHËNIMI I PIKËS, TË FITUARIT E SETIT DHE NDESHJES

6.1 SHËNIMI I PIKËS

6.1.1 Pika

Ekipi shënon pikë:

6.1.1.1 duke e prekur topin me sukses në fushën e kundërshtarit;

D9 (14)

6.1.1.2 kur skuadra kundërshtare kryen një gabim;

6.1.1.3 kur skuadra kundërshtare merr një dënim.

6.1.2 Gabim

Një ekip kryen një gabim duke bërë një veprim loje në kundërshtim me rregullat (ose duke i shkelur ato në ndonjë mënyrë tjetër). Gjyqtarët gjykojnë gabimet dhe përcaktojnë pasojat sipas rregullave:

6.1.2.1 nëse kryhen dy ose më shumë gabime radhazi, llogaritet vetëm i pari;

6.1.2.2 nëse dy ose më shumë gabime kryhen nga kundërshtarët njëkohësisht, thirret një gabim i dyfishtë dhe riluhet aksioni.

D9 (23)

6.1.3 Aksioni dhe aksioni i përfunduar

Aksioni është sekuenca e veprimeve të lojës që nga momenti i goditjes së shërbimit nga lojtari derisa topi është jashtë loje.:

8.1, 8.2,
12.2.2.1,
12.4.4,
22.3.2.2

- Dhënies së denimit
- Humbja e shërbimit pas skadimit të kohës për shërbim.

6.1.3.1 Nëse skuadra që shërben fiton një aksion, ajo shënon një pikë dhe vazhdon të shërbejë.

6.1.3.2 Nëse ekipi që pranon fiton një aksion, ajo shënon pike dhe radhen e shërbimitit.

6.2 TË FITUARIT E SETIT

Një set (përveç setit të tretë vendimtar) fitohet nga skuadra që së pari shënon 21 pikë me një avantazh minimal prej dy pikësh. Në rastin e barazimit 20-20, loja vazhdon derisa të arrihet një avantazh prej dy pikësh (22-20; 23-21; etj).

D9 (9)

6.3 TË FITUARIT E NDESHJES

6.3.1 Ndeshja fitohet nga ekipi i cili fiton dy sete.

6.3.2 Në rast të barazimit 1-1 në sete, luhet seti i 3-të deri në 15 pikë apo me epërsi minimale prej 2 pikëve.

D9 (9)

6.4 EKIPI I PAKOMPLETUAR

6.4.1 Nëse një skuadër refuzon të luajë pasi thirret për ta bërë një gjë të tillë, ajo shpallet në mungesë dhe e humb ndeshjen me rezultatin 0-2 për ndeshjen dhe 0-21, 0-21 për çdo set.

6.4.2 Një skuadër që nuk paraqitet në kohën e duhur në fushën e lojës, deklarohet si e paracaktuar.

6.4.3 Një skuadër që shpallet E PAKOMPLETUAR për setin ose për ndeshjen, humbet setin ose ndeshjen. Skuadrës kundërshtare i jepen pikët, ose pikët dhe setet, të nevojshme për të fituar setin ose ndeshjen. Skuadra jo e plotë ruan pikët dhe setet

6.4.1

6.2, 6.3, 7.3.1

Për garat botërore dhe zyrtare, kurdoherë që zbatohet formati i lojës në grupe, Rregulli 6.4 më sipër mund t'i nënshtrohet modifikimeve siç thuhet në Rregulloret Specifike të Konkurrencës të nxjerra nga FIVB në kohën e duhur, duke vendosur modalitetin që duhet ndjekur për trajtimin e rasteve të parazgjedhura dhe jo të plota të ekipit.

7 STRUKTURA E LOJËS

7.1 SHORTI

Përpara nxehmjes zyrtare, gjyqtari i parë thërret për të vendosur mbi shërbimin e parë dhe anët e fushës në setin e pare.

Hedhja kryhet në prani të dy kapitenëve të ekipit, sipas rastit.

7.1.1 Fituesi i shortit zgjedhë:

OSE

7.1.1.1 Të drejten e shërbimit ose pranimit të shërbimit ,

OSE

7.1.1.2 anën e fushës së lojës.

Humbësi i shortit zgjedhë pjesen e mbetur.

7.1.1.3 Në setin e dytë humbësi i shortit në setin e parë do të ketë zgjedhjen e 7.1.2.1 ose 7.1.2.2.

Shorti i ri do të hedhet në rast të setit final.

7.2 SEANCA ZYRTARE E NXEMJES

Përpara ndeshjes, nëse skuadrat kanë pasur më parë në dispozicion një fushë tjetër loje, ato do të kenë një periudhë zyrtare 3-minutëshe nxehjeje në rrjetë; nëse jo, ata mund të kenë 5 minuta.

7.3 FORMACIONET E EKIPEVE

7.3.1 Të dy lojtarët e seciles skuadër duhet të jenë gjithmonë në lojë.

4.1.1

7.4 POZICIONIMI NË FUSHË

Në momentin që topi goditet nga shërbyesi, çdo ekip duhet të jetë brenda fushës së vet (përveç shërbyesit).

7.4.1 Lojtarët janë të lirë të pozicionohen. NUK ka qëndrime të përcaktuara në fushë.

7.5 GABIMET NË VENDOSJE

7.5.1 Nuk ka gabime në radhen e vendosjes në fushë.

7.6 RADHA E SHËRBIMIT

7.6.1 Radha e shërbimit duhet të mbahet gjatë gjithë setit (siç përcaktohet nga kapiteni i ekipit menjëherë pas hedhjes së shortit).

7.6.2 Kur ekipi pritës ka fituar të drejtën për të shërbyer, lojtarët e tij "rrrotullohen" për një pozicion.

7.7 GABIMET NË RADHËN E SHËRBIMIT

7.7.1 Një gabim në shërbimit kryhet kur shërbimi nuk është bërë sipas radhës së shërbimit. Skuadra sanksionohet me pikë dhe shërbim ndaj kundërshtarit.

D9 (13)

7.7.2 Pikëshenuesit duhet të tregojnë saktë radhen e shërbimit dhe të korrigojnë çdo shërbyes të pasaktë përpara sinjalit për shërbim.

KAPITULLI 4 AKSIONET GJATË NDESHJES

See Rules

8 KUSHTET E LOJËS

8.1 TOPI NË LOJË

Topi është në lojë që nga momenti i goditjes së shërbimit të autorizuar nga gjyqtari i parë.

12, 12.3

8.2 TOPI JASHTË LOJE

Topi është jashtë loje në momentin e gabimit, i cili gjykohet nga njëri prej gjyqtarëve; në mungesë të një gabimi, në momentin e fishkllimës.

8.3 TOPI “BRENDA”

Topi është “brenda” në çdo situatë të kontaktit të tij me sipërfaqen e fushës, nëse një pjesë e topit prek fushën, duke përfshirë kontaktin e vijave kufizuese.

D9 (14),
D10 (1)

8.4 TOPI “JASHTË”

Topi është “jashtë” kur:

8.4.1 bie në tokë plotësisht jashtë vijave kufizuese (pa i prekur ato);

1.3.2, D9 (15),
D10 (2)

8.4.2 prek një objekt jashtë fushës, ose një person jashtë loje;

D9 (15),
D10 (4)

8.4.3 prek antenat, litarët, shtyllat ose vetë rrjetën jashtë shirtave anësor të rrjetës;

2.3, D3, D4a,
D9 (15),
D10 (4)

8.4.4 kalon rrafshin vertikal të rrjetës pjesërisht ose tërësisht jashtë hapësirës së kalimit gjatë shërbimit ose gjatë goditjes së tretë të ekipit (përgjashtim: Rregulli 10.1.2)

2.3, 10.1.2,
D4a, D9 (15),
D10 (4)

8.4.5 kalon plotësisht hapësirën e poshtme nën rrjetë.

D4a, D9 (22)

9 LOJA ME TOP

Çdo ekip duhet të luajë brenda zonës së vet të lojës dhe hapësirës së lojës (përveç rregullit 10.1.2).

10.1.2

Megjithatë, topi mund të merret nga përtej zonës së tij të lirë dhe mbi tabelën e shënimeve në shtrirjen e tij të plotë.

9.1 TAKIMET ME TOPIN

Takim është çdo kontakt i lojtarit me topin në lojë .

Çdo ekip ka të drejtë maksimum tri takime-goditje për kthimin e topit mbi rrjetë. Nëse përdoren më shumë, skuadra kryen gabimin e "KATËR TAKIMEVE".

Këto goditje takime përfshijnë jo vetëm goditje të qëllimshme nga lojtari, por edhe kontakte të paqëllimshme me topin.

9.1.1 TAKIMET E NJËPASNJËSHME

Një lojtar nuk mund të godasë topin dy herë radhazi (përjashtimet, shih Rregullat: 9.2.2.2, 9.2.2.3, 14.2 dhe 14.4.2).

9.2.2.1, 14.2,
14.4.2, D9 (17)**9.1.2 KONTAKTET SIMULTANTE**

Dy lojtarë mund ta prekin topin në të njëjtën kohë.

9.1.2.1 Kur dy shokë të skuadrës prekin topin njëkohësisht, ai llogaritet si dy goditje (me përjashtim të bllokut).

14.2

Nëse ata arrijnë topin, por vetëm njëri prej tyre e prek atë, llogaritet një takim.

Nëse lojtarët përplasen, nuk referohet gabim.

9.1.2.2 Kur dy kundërshtarë prekin topin në të njëjtën kohë mbi rrjetë dhe topi mbetet në lojë, skuadra që merr topin ka të drejtë për tre takime të tjera. Nëse një top i tillë del "jashtë", është faji i skuadrës në anën e kundërt.**9.1.2.3 Nëse goditjet e njëkohshme të dy kundërshtarëve mbi rrjetë çojnë në një kontakt të zgjatur me topin, loja vazhdon.**

9.1.2.2

9.1.2.4 Nëse topi godet antenën pas goditjeve të njëkohshme nga dy kundërshtarë mbi rrjetë, aksioni duhet të riluhet.**9.1.3 GODITJET-PREKJET E ASISTUARA**

Brenda zonës së lojës, një lojtar nuk lejohet të marrë mbështetje nga një shok i skuadrës ose ndonjë strukturë/objekt për të goditur topin.

Megjithatë, një lojtar që është gati të kryejë një gabim (prek rrjetën ose ndërhyr me një kundërshtar, etj.) mund të ndalohet ose të mbahet prapa nga një shoku i skuadrës.

9.2 KARAKTERISTIKAT E GODITJES-PREKJES SË TOPIT		
9.2.1	Topi mund të preket me secilen pjesës të trupit.	
9.2.2	Topi nuk duhet të kapet ose të hidhet. Mund të kthehet në çdo drejtim.	9.3.3
9.2.2.1	Kontaktet e njëkohshme: Topi mund të prekë pjesë të ndryshme të trupit, me kusht që kontaktet të ndodhin njëkohësisht.	9.2.1
9.2.2.2	Kontaktet e njëpasnjëshme: Në prekjen e parë të skuadrës, të mos bëhet me gishta) kontaktet e njëpasnjëshme lejohen me kusht që kontaktet të ndodhin gjatë një veprimi. gishtat/duart radhazi, edhe nëse kontaktet ndodhin gjatë një veprimi.	9.3.4
9.2.2.3	Megjithatë, në bllok, kontaktet e njëpasnjëshme mund të bëhen nga një ose më shumë lojtarë, me kusht që ato të ndodhin gjatë një veprimi ;	14.2
9.2.2.4	Kontaktet e zgjatura: Në veprimin mbrojtës të një topi të gjuajtur fort, kontakti i topit mund të zgjatet për momentin edhe nëse përdoret një veprim me gishta.	
9.3 GABIMET GJATË LOJËS ME TOP		
9.3.1	KATËR TAKIME: ekipi prek topin katër here para se ta kthejë atë.	9.1, D9 (18)
9.3.2	GODITJE E ASISTUAR: lojtari merrë ndihmë nga bashkëlojtari apo ndonjë object/structure për të goditur topin në fushën e lojës.	9.1.3
9.3.3	MBAJTJA : topi mbahet ose hedhet; nuk rikthehet nga goditja. (Përfshijmë 9.2.2.1, 9.2.2.2).	9.2.2, D9 (16)
9.3.4	KONTAKT I DYFISHTË: një lojtar godet topin dy herë radhazi ose topi kontakton me pjesë të ndryshme të trupit të tij/saj dy here radhazi.	9.1.1, 9.2.2.2, D9 (17)
10 TOPI NË RRJETË		
10.1 KALIMI I TOPIT MBI RRJETË		
10.1.1	Topi i dërguar në fushën e kundërshtarit duhet të kalojë mbi rrjetë brenda hapësirës së kalimit. Hapësira e kalimit është pjesa e rrafshit vertikal të rrjetës e kufizuar si më poshtë:	D4a
10.1.1.1	poshtë, nga maja e rrjetes;	
10.1.1.2	nga vija anësore, nga antenna dhe shtrirja e tyre imagjinare;	
10.1.1.3	nga lartë, deri te kulmi ose ndonje object tjetër(nese ka).	

- 10.1.2 Topi që ka kaluar rrafshin vertikal të rrjetës në zonën e lirë të kundërshtarit tërësisht ose pjesërisht përmes hapësirës së jashtme, mund të luhen brenda goditjeve të ekipit, me kusht që: 9.1, D4b
- 10.1.2.1 Topi kur luhet përsëri kalon rrafshin vertikal të rrjetës plotësisht ose pjesërisht përmes hapësirës së jashtme në të njëjtën anë të fushës.. D4b
Skuadra kundërshtare nuk mund të parandalojë një veprim të tillë.
- 10.1.3 Topi është “jashtë” kur kalon plotësisht hapësirën e poshtme nën rrjetë.
- 10.1.4 Megjithatë, një lojtar mund të hyjë në fushën e kundërshtarit për të luajtur topin përpara se të kalojë jashtë hapësirës së kryqëzimit, ose përpara se të kalojë plotësisht hapësirën e poshtme.. 10.1.3

10. PREKJA E RRJETËS ME TOP

Gjatë kalimit mbi rrjetë, topi mund ta prekë atë.

10.1.1

10.3 TOPI NË RRJETË

- 10.3.1 Një top i futur në rrjetë mund të rikuperohet brenda kufijve të tre goditjeve të ekipit. 9.1
- 10.3.2 Nëse topi këput rrjetën e rrjetës ose e shemb atë, aksioni anulohet dhe riluhet.

11 LOJTARI NË RRJETË

11.1 KALIMI PËRTEJ RRJETËS

- 11.1.1 Në bllok, një lojtar mund të prekë topin përtej rrjetës, me kusht që ai/ajo nuk ndërhyr në lojën e kundërshtarit, përpara se ai të godasë topin. 14.1, 14.3
- 11.1.2 Pas një sulmi, një lojtar lejohet të kalojë dorën e tij/saj përtej rrjetës, me kusht që kontakti të jetë bërë brenda hapësirës së tij/saj të lojës.

11.2 KALIM NË FUSHËN, APO ZONËN E LIRË TË KUNDËRSHTARIT

- 11.2.1 Një lojtar mund të hyjë në hapësirën, fushën dhe/ose zonën e lirë të kundërshtarit, me kusht që kjo të mos ndërhyjë në lojën e kundërshtarit. 10.1.4

11.3 KONTAKTI ME RRJETEN

- 11.3.1 Kontakti-prekja e rrjetës nga një lojtar ndërmjet antenave, gjatë një aksioni të lojës, është një gabim. 11.4.3, 22.3.2.3.c, 26.3.2.2, D3
Aksioni i lojës përfshin (ndër të tjera) shkëputjen, goditjen (ose tentativën) dhe uljen e sigurt, gati për një aksion të ri.

- 11.3.2 Lojtarët mund të prekin shtyllën, litarët ose çdo objekt tjetër jashtë antenave, duke përfshirë vetë rrjetën, me kusht që të mos ndërhyjë ne lojë (përveç rregullit 9.1.3).
- 11.3.3 Kur topi bie në rrjetë, duke e bërë atë të prekë një kundërshtar, nuk shkaktohet “faull”.

11.4 GABIMET E LOJTARIT NË RRJETË

- 11.4.1 Një lojtar prek topin në hapësirën e kundërshtarit përpara se ai ta godasë apo sulmoj.
- 11.4.2 Një lojtar ndërhyr në lojën e kundërshtarit ndërsa depërton në hapësirën e kundërshtarit nën rrjetë.
- 11.4.3 Një lojtarë ndërhyr në lojë (ndër të tjera edhe duke):
- Prekur rrjetën në mes të antenave apo antenat gjatë aksionit për të luajtur me top.
 - duke përdorur rrjetën si mbështetje ose ndihmë stabilizuese
 - krijuar avantazh “jo fer” ndaj kundërshtarit duke përdorur rrjeten
 - duke bërë veprime që pengojnë përpjekjen legjitime të kundërshtarit për të luajtur me topin,
 - kapur/mbajtur në rrjetë

11.3.1, D3

Çdo lojtar afër topit ndërsa luhet dhe që është ai/ajo që përpiket ta luajë, konsiderohet në aksionin e lojës me top, edhe nëse nuk ka kontakt me të.

Megjithatë, prekja e rrjetës jashtë antenës nuk duhet të konsiderohet si gabim (përveç rregullit 9.1.3.)

12 SHERBIMI

Shërbimi është akti i futjes së topit në lojë nga lojtari që ka radhën e shërbimit, i vendosur në zonën e shërbimit.

12.1 SHERBIMI I PARË NË SET

- 12.1.1 Shërbimi i pare në set kryhet nga ekipi i përcaktuar nga hedhja e shortit.

6.3.2, 7.1

12.2 RADHA E SHERBIMIT

- 12.2.1 Lojtarët duhet të ndjekin radhën e shërbimit sipas procesverbalit.
- 12.2.2 Pas shërbimit të pare në set, radha e lojtarit që duhet të shërbej definohet:
- 12.2.2.1 Kur ekipi që shërben fiton aksionin, lojtari që ka shërbyer, shërben përsëri.
- 12.2.2.2 kur ekipi që ka pranuar shërbimin fiton aksionin, fiton të drejtën e shërbimit dhe lojtari i cili nuk ka shërbyer më heret duhet të shërbej.

12.3 AUTORIZIMI I SHËRBIMIT

Gjyqtari i pare autorizon shërbimin, pasi të ketë kontrolluar që të dyja skuadrat janë gati për të luajtur dhe që lojtari është në zotërim të topit.

D9 (1)

12.4 EKZEKUTIMI I SHËRBIMIT

12.4.1 Topi duhet të goditet me një rën dorë ose me ndonjë pjesë të krahut pasi të hidhet ose lëshohet nga dora/uart.

D9 (10)

12.4.2 Lejohet vetëm një gjuajtje ose lëshim i topit. Lëvizja e topit në duar lejohet.

12.4.3 Lojtari mund të lëvizë lirshëm brenda zonës së shërbimit. Në momentin e goditjes ose kërcimit në rastin e shërbimit me kërcim, lojtari nuk duhet të prekë fushën (përfshirë vijën fundore) ose tokën jashtë zonës së shërbimit. Këmba e tij/saj nuk mund të futet nën vijën fundore.

1.4.2, D9 (22),
D10 (4)

After the hit, he/she may step or land outside the service zone, or inside the court. If the line moves because of the sand pushed by the server, it is not considered a fault.

12.4.4 Lojtari duhet të godasë topin brenda 5 sekondave pasi gjyqtari i parë jepë shenjë për shërbim..

D9 (11)

12.4.5 Shërbimi që ekzekutohet para se të ipet shenjë nga gjyqtari, përsëritet.

D9 (23)

12.4.6 Nëse topi, pasi është hedhur ose lëshuar nga lojtari, bie në tokë pa u prekur ose kapur , ai konsiderohet si shërbim..

12.4.7 Nuk lejohet që të shërbehet prapë.

12.5 EKRANI

12.5.1 Lojtari i skuadrës që shërben nuk duhet të pengojë kundërshtarin, nëpërmjet “ekranit” individual, të shohë goditjen e shërbimit dhe rrugën e fluturimit të topit.

D9 (12)

D5

12.5.2 Lojtari i ekipi që shërben bën një ekran duke tundur krahët, duke kërcyer ose duke lëvizur anash gjatë ekzekutimit të shërbimit, në mënyrë që goditja e shërbimit dhe rruga e fluturimit të topit të fshihen derisa topi të arrijë në rrafshin vertikal të rrjetës. Nëse duhet të jetë i dukshëm për ekipin marrës, ky nuk është një ekran.

D5

12.6 GABIMET GJATË SHËRBIMIT

12.6.1 Gabimet në shërbim

Gabimet e mëposhtme çojnë në një ndryshim të shërbimit. Sherbyesi:

12.2, D9 (13)

12.6.1.1 Gabon radhen e shërbimit,

12.6.1.2 Nuk e ekzekuton shërbimin si duhet.

12.4

12.6.2 Gabimet pas goditjes së shërbimit

Pasi topi është goditur saktë, shërbimi bëhet gabim nëse topi:

- 12.6.2.1 prek një lojtar të ekipit që shërben ose nuk arrin të kalojë plotësisht rrafshin vertikal të rrjetës përmes hapësirës së lojës; D9 (19)
- 12.6.2.2 topi del “jashtë”; 8.4, D9 (15)
- 12.6.2.3 kalon mbi “ekran” D5

13 GJUAJTJA-SULMI

13.1 KARAKTERISTIKAT E GJUAJTJES

- 13.1.1 Të gjitha veprimet që drejtojnë topin drejt kundërshtarit, me përjashtim të shërbimit dhe bllokut, konsiderohen si gjuajtje (sulum).
- 13.1.2 Një gjuajtje-sulum përfundon në momentin kur topi kalon plotësisht në rrafshin vertikal të rrjetës ose preket nga një kundërshtar..
- 13.1.3 Çdo lojtar mund të kryejë një gjuajtje-sulum nga çdo lartësi, me kusht që kontakti i tij/saj me topin të jetë bërë brenda hapësirës së lojës së lojtarit (përveç rregullit 13.2.4, 13.2.5 më poshtë). 13.2.4, 13.2.5

13.2 GABIMET NË GJUAJTJE-SULM

- 13.2.1 Një lojtar godet topin brenda hapësirës së lojës së ekipit kundërshtar. 13.1.2, D9 (20)
- 13.2.2 Lojtari gjuan topin “jashtë”. 8.4, D9 (15)
- 13.2.3 lojtar kryen një gjuajtje duke përdorur një veprim të gishtit të hapur ose nëse përdor majat e gishtave që nuk janë të ngurtë dhe të bashkuar. D9 (21)
- 13.2.4 Një lojtar bënë një gjuajtje të shërbimit të kundërshtarit, kur topi është tërësisht mbi nivelin e rrjetës. D9 (21)
- 13.2.5 Një lojtar përfundon një gjuajtje duke përdorur një pasim mbi kokë që ka një trajektore jo pingul me vijën e shpatullave. Përjashtim është kur lojtari po përpiqet të pasoj topin te shoku i tij ose i saj. D9 (21)

14 BLOKU

14.1 TË BLOKUARIT

- 14.1.1 Blloku është veprimi i lojtarëve pranë rrjetës për të kapur topin që vjen nga kundërshtari duke arritur më lart se maja e rrjetës, pavarësisht nga lartësia e kontaktit të topit. Në momentin e kontaktit me topin, një pjesë e trupit duhet të jetë më e lartë se pjesa e sipërme e rrjetës..

14.1.2 Tentimi i bllokut

Tentimi për bllok është aksioni i bllokut pa e prekur topin.

14.1.3 Blloku i kompletuar

Blloku i kompletuar është çdo here kur topi preket nga lojtari bllokues.

D6

14.1.4 Blloku kolektiv

Një bllok kolektiv ekzekutohet nga dy lojtarë afër njëri-tjetrit dhe përfundon kur njëri prej tyre prek topin.

14.2 BLOK KONTAKTET

Kontaktet e njëpasnjëshme (të shpejta dhe të vazhdueshme) mund të ndodhin nga një ose më shumë bllokues me kusht që kontaktet të bëhen gjatë një aksioni. Këto llogariten si vetëm një goditje e ekipit. Këto kontakte mund të ndodhin me çdo pjesë të trupit..

9.1.1, 9.2.3

14.3 BLOKU BRENDA HAPËSIRËS SË KUNDËRSHTARIT

Në bllok, lojtari mund të vendosë duart dhe krahët e tij/saj përtej rrjetës, me kusht që ky veprim të mos ndërhyjë në lojën e kundërshtarit. Kështu, nuk lejohet prekja e topit përtej rrjetës përpara se kundërshtari të ketë ekzekutuar një gjuajtje sulmi.

13.1.1

14.4 BLOKU DHE TAKIMET E SKUADRES

14.4.1 Kontakti në bllok numërohet si takim. Skuadra që ka bërë bllok ka të drejten edhe të dy takimeve të tjera, pas prekjës në bllok.

14.4.2 Takimi i parë pas bllokut mund të ekzekutohet nga çdo lojtar, duke përfshirë edhe atë që ka prekur topin gjatë bllokut..

14.5 BLOKIMI I SHËRBIMIT

Bllokimi i shërbimi të ekipit kundërshtar nuk lejohet.

D9 (12)

14.6 GABIMET NË BLOK

14.6.1 Bllokuesi prek topin në hapësirën e kundërshtarit përpara se të godasë sulmoj ekipi kundërshtarë.

14.3, D9 (20)

14.6.2 Bllokimi i topit në hapësirën e kundërshtarit nga jashtë antenës.

14.6.3 Lojtari bllokton shërbimin e ekipit kundërshtarë.

D9 (12)

14.6.4 Topi del “jashtë” pas prekjës nga blloku.

D9 (24)

KAPITULLI 5 NDËRPRERJET, VONESAT AND INTERVALET

See Rules

15 NDËRPRERJET

Një ndërprerje është koha ndërmjet një aksioni të përfunduar dhe fishkëllimës së gjyqtarit të parë për shërbimin e radhës.

Ndërprerjet e vetme të rregullta të lojës janë “time out” pushimet.

D9 (4)

15.1 NUMRI I NDERPRERJEVE TË RREGULLTA TË LOJËS

Secili ekip mund të kërkojë një pushim për set.

15.2 SEKUENCA E NDËRPRERJEVE TË RREGULLTA TË LOJËS

15.2.1 Kërkesat për pushim nga të dyja skuadrat mund të pasojnë njëra-tjetrën, brenda të njëjtës ndërprerje..

15.2.2 Nuk ka ndërrime të lojtarëve.

15.2.3 Nuk lejohet të kërkojë ndonjë ndërprerje e rregullt e lojës pasi të jetë refuzuar një kërkesë dhe sanksionuar me një paralajmërim vonese gjatë të njëjtës ndërprerje (d.m.th. përpara përfundimit të aksionit tjetër të përfunduar).

15.3 KËRKESA PËR NDËRPRERJE TË RREGULLTA TË LOJËS

